



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

RAPORT MBI GJENDJEN NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

1 tetor 2014 - 20 mars 2015

**RAPORT I DORËZUAR TEK BASHKIMI EVROPIAN / SHËRBIMI
EVROPIAN PËR VEPRIM TË JASHTËM**

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 23 mars 2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, si palë konstruktive dhe serioze në Dialogun e Brukselit, i jep rëndësi të veçantë zbatimit të gjitha Marrëveshjeve të Brukselit të katër viteve të fundit.

Në mënyrë periodike jemi duke e vlerësuar gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun e Brukselit, në mënyrë që të vihen në pah progresi dhe sfidat e këtij procesi si dhe të paraqesim pikëpamjet tona për rrugën për të ecur përpara drejt një progres më të mirë në zbatim. Besojmë se angazhimi për zbatimin e marrëveshjeve nga të gjitha palët është e vetmja mënyrë për të siguruar besueshmërinë me atë çfarë u dakordua dhe u nënshkrua në dialogun politik dhe teknik të Brukselit.

Shpresoj që ky Raport (si ata të mëparshmit) do të ndihmojë që të merren në konsideratë mundësitë dhe stimujt për avancimin e procesit të përgjithshëm të zbatimit të marrëveshjeve të arritura në dialogun teknik dhe politik. Një fokus i veçantë i jepet Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve të datës 19 prill 2013.

Raporti përfshinë periudhën nga 1 tetori 2014 deri më 20 mars 2015, ku për dallim nga periudhat e mëparshme, procesi i zbatimit nuk ka shënuar ndonjë progres të rëndësishëm. Zhvillimi më i rëndësishëm është Marrëveshja për zbatim në fushën e drejtësisë e arritur në 9-10 shkurt të vitit 2015 në Bruksel. Shpresojmë për zbatimin e saj sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me marrëveshjet e tjera që janë në pritje.

Raporti veçanërisht vë në pah çështjet e rëndësishme që presin zgjidhje: "mbrojtja civile" – ende nuk është shuar në mënyrë që t'i mundësojë pjesëtarëve të saj të integrohen në institucionet civile të Kosovës; kodi ndërkombëtar telefonik për Kosovën ende i pazgjidhur që nga shtatori i vitit 2013 kur është arritur marrëveshja; barrikada/e ashtuquajtura Parku i Paqes i vendosur mbi urën në Mitrovicë ende nuk është hequr; marrëveshja për sigurimin e automjeteve është ende në pritje, pavarësisht faktit se është negociuar për gati dy vite, etj. Çështja e Asociacionit mbetet që të diskutohet. Kosova pohon se çështja e asociacionit mund të adresohet vetëm pas zbatimit të marrëveshjeve për drejtësinë, sigurinë dhe shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë dhe largimin e barrikadës në urën e Mitrovicës dhe të tjerat përreth.

Raporti me theks vë në pah zhvillimet negative që ndërlidhen me ndërhyrjet e vazhdueshme të paligjshme të Serbisë në Kosovë përmes mbajtjes së strukturave të saj paralele, në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve. Serbia ka forcuar dhe zgjeruar edhe më tej strukturat paralele në Kosovë, veçanërisht që nga tetori i vitit të kaluar. Si pasojë, kjo ka dëmtuar në mënyrë dramatike punën e kryetarëve dhe strukturave legale komunale në katër komunat veriore të Kosovës, të cilat që nga zgjedhjet lokale të vitit 2013 kanë kaluar në qeverisje legale të çështjeve lokale. Për më tepër, Serbia ka ndërhyrë për të parandaluar miratimin e buxheteve legale nga ana e këtyre komunave për shkak të arsyeve politike (duke u munduar të parandalojë sektorin e arsimit dhe shëndetësisë që të integrohet në sistemin e Kosovës). Për shkak të mosmiratimit të buxheteve legale, këto komuna janë duke u përballur me bllokime buxhetore që nga 1 marsi i vitit 2015. Për më tepër, gjatë vitit 2014, Serbia kryesisht ka dështuar të zbatojë marrëveshjet e Brukselit duke krijuar kështu tensione të panevojshme, duke përfshirë ndërrimin e një barrikade më një tjetër në Urën e Mitrovicës, në dëm të stabilitetit dhe lirisë së lëvizjes.

Qeveria e Kosovës beson fuqimisht se procesi i zbatimit mund të kishte përparuar më shumë në qoftë se Serbia do të tregonte më shumë vullnet politik për zbatimin e marrëveshjeve dhe të përmbahej nga shkeljet ose shmangia e obligimeve të dialogut.

Kosova nga ana e sajë ishte plotësisht e angazhuar që të zbatoj marrëveshjet. Madje edhe gjatë periudhës pas zgjedhjeve nacionale e deri në krijimin e qeverisë së re, Kosova mbeti aktivisht e përfshirë në dialogun në nivel teknik me përpjekje që të arrihet progres në zbatimin e marrëveshjeve. Kjo sepse ne e vlerësojmë seriozisht rëndësinë e dialogut të Brukselit, jo vetëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve, por sepse ky dialog është aktualisht kontribuuesi më i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Qeveria e Kosovës dëshiron të potencoj se zbatimi i marrëveshjeve është i rëndësishëm për suksesin e plotë të këtij dialogu dhe arsyeton vazhdimin e tij. Ne vlerësojmë lartë rolin lehtësues të Bashkimit Evropian dhe fuqinë e garantimit të rezultateve të dialogut si dhe mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, besojmë fuqishëm se politikat e matjes se performancave dhe masat stimuluese dhe kushtëzimet për të dy shtetet në rrugën e tyre për integrimin evropian, janë mekanizma të nevojshëm për të siguruar progresin e duhur në këtë dialog.

Në këtë drejtim, me meritë, presim më shumë mbështetje nga BE-ja për progresin e

Kosovës drejt integritit në BE, përkatësisht nënshkrimin e marrëveshjes së MSA-së mes Kosovës dhe BE-së, në pjesën e parë të këtij viti dhe ratifikimin e sajë gjatë vitit, si dhe dhënien e statusit të kandidatit për Kosovën në të ardhmen e afërt. Gjithashtu, ju bëjmë thirrje pesë vendeve anëtare të BE-së që të njohin Kosovën, sepse përmes njohjes do të kontribuonin në mënyrë të drejtpërdrejt për paqe të qëndrueshme dhe stabilitet në rajon sidomos në kontekstin e dinamikave të reja gjeopolitike që burojnë nga disa vende jo-perëndimore.

Në të njëjtën kohë, besojmë se Serbia duhet të ketë vullnet politik për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Në këtë drejtim, besojmë se Kapitulli 35 i cili i kushtëzon bisedimet për anëtarësimin e Serbisë me zbatimin e plotë të marrëveshjeve të Brukselit duke synuar normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore me Kosovën, është një nga instrumentet më të rëndësishme të kushtëzimit nga ana e BE-së. Ne i bëjmë thirrje BE-së dhe shteteve anëtare të sajë që të mbështesin këtë mekanizëm, në linjë me qëndrimin e Gjermanisë, për shkak se në këtë mënyrë sigurohet përparim i mëtejshëm në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, me të kaluar të trazuar.

Ekziston edhe një motiv shtesë që dialogu i Brukselit të jetë një histori e suksesit. Kjo për shkak se mund të shërbej si një model pozitivë që mund të përdoret në adresimin e çështjeve tjera të hapura në rajon dhe përtej.



Edita Tahiri
Ministër për Dialog

Parathënia	2
Përmbajtja	5
Përmbledhja ekzekutive	6
1. Funksionimi i brishtë i komunave veriore të Kosovës	9
2. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë - duhet të hiqen	10
3. Siguria	12
4. Drejtësia	14
5. Barrikada në urën e Mitrovicës	15
6. Asociacioni	15
7. Telekomunikacioni	16
8. Energjia	16
9. IBM/MIK	18
10. Sigurimi i automjeteve	19
11. Bashkëpunimi rajonal	21
12. Zyrat ndërlidhëse	22
13. Mbledhja e të hyrave nga dogana	23
14. Fondi për zhvillim	24
15. Lëvizja e lirë	24
16. Tregtia e lirë	25
17. Ligji mbi amnistinë	25
18. Kadastri	25
19. Diplomat	26
20. Regjistri civil	27
Lista e shkurtesave	28

Ky Raport mbi gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit paraqet vlerësimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë proces. Ai shqyrton progresin dhe sfidat në këtë proces në periudhën nga 1 tetori 2014 deri më 20 mars 2015. Analizat fokusohen në procesin e zbatimit, nivelet e ndryshme të zbatimit të secilës marrëveshje, çështjet e pazgjidhura dhe arsyet për rezultate të tilla.

Gjetjet e Raportit tregojnë për një progres të ulët në zbatimin e marrëveshjeve në përgjithësi. Duke parë marrëveshjet veç e veç, Raporti identifikon nivele të ndryshme progresi në disa fusha dhe mungesë progresi në shumicën e fushave.

Ndër faktorët që kanë pasur më shumë ndikim në rezultate, dy prej tyre konsiderohen më relevant. Faktori i parë, është rënia e dinamikave të dialogut për shkak të zgjedhjeve në Kosovë, Serbi dhe BE gjatë vitit 2014. Faktori i dytë, ka të bëjë lëvizjet regresive nga ana e Serbisë përmes forcimit të strukturave të saja paralele në Kosovë, në vend që ta bëjë shpërbërjen e tyre ashtu siç kërkon Marrëveshja e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve.

Qeveria e Kosovës beson se është krijuar një momentum i ri në dialogun e Brukselit përmes rinisjes së takimeve të nivelit të lartë politikë në muajin shkurt të këtij viti, duke rritur shpresat për më shumë progres në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura dhe në përshpejtimin e zbatimit praktik të marrëveshjeve. Takimi i 9-10 shkurtit, në mes të Kryeministrit të Kosovës z. Mustafa, Kryeministrit të Serbisë z. Vuçiç dhe PS Mogherini që rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes për Drejtësi, sigurisht se hap perspektiva të reja për arritjen e qëllimeve të dialogut.

Sa i përket zbatimit, gjenda është si më poshtë:

PPROGRES I MIRË ËSHTË ARRITUR NË:

- Marrëveshja për drejtësi - e arritur më 09-10 janar 2015, duke hapur dyert për zbatimin praktik në themelimin e sistemit unitar të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës dhe integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve serbë në institucionet e drejtësisë së Kosovës.
- Licencimin e kompanive nga veriu i Kosovës për mallrat e kontrolluara - pjesë e marrëveshjes për të hyrat doganore e janar 2013 - zbatimi filloi më 1 janar 2015.

- Zyrrat ndërlihdëse - kanë zgjeruar përgjegjësitë e tyre në administrimin e kërkesave për vizita zyrtare në mes dy shteteve, zbatimi filloi më 1 dhjetor 2015

NUK KA PASUR PROGRES NË:

- Shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë - në vend të shpërbërjes, Serbia po i zgjeron ato në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit.
- "Mbrotjta civile" - ende nuk është shpërbërë, për ti krijuar mundësinë pjesëtarëve të saj që të integrohen në institucionet civile të Kosovës; bisedimet mbi këtë çështje janë duke vazhduar që nga dhjetori i vitit 2013.
- Telekomunikacion - kodi ndërkombëtar telefonik për Kosovën ende i pazgjidhur që nga shtatori i vitit 2013, kur është arritur marrëveshja.
- Energjia - Autoriteteve të Kosovës ende nuk u është dhënë kontrolli mbi nën-stacionin e Vallaçit. Problemet rreth regjistrimit të kompanisë së re janë duke zvarritur zbatimin për shkak të tendencave të Serbisë në fushën e distribuimit të energjisë që janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit.
- Barrikada/ e ashtuquajtura "Parku i paqes" i vendosur në urën në Mitrovicë - nuk është larguar ende, megjithëse në korrik të vitit 2014 është arritur marrëveshja në Bruksel.
- Marrëveshja për sigurimin e automjeteve - ende në pritje pavarësisht faktit se është negociuar për gati dy vjet. Kosova e konfirmoi pranimin në dhjetor të vitit 2014, ndërsa Serbia po e vonon pranimin edhe në ditët e sotme. Nënshkrimi i marrëveshjes ishte planifikuar të bëhej nga mesi i janarit dhe më pas për 24 mars të vitit 2014, por prapë më 20 mars është anuluar nga ana e Serbisë.
- Çështja e Asociacionit mbetet që të diskutohet. Statuti i asociacionit të komunave me shumicë Serbe do të jetë në përputhje me ligjet ekzistuese të Kosovës, ashtu siç kërkohet në Marrëveshjen e Brukselit të 19 prillit të vitit 2013. Kjo do të thotë se Asociacioni nuk mund të ketë kompetenca ekzekutive dhe as mbikëqyrëse. Kosova pohon se kjo çështje mund të adresohet vetëm pas zbatimit të marrëveshjeve për drejtësinë, "mbrotjtjen civile", shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele të Serbisë në Kosovë dhe heqjen e barrikadës në urën e Mitrovicës dhe të tjerave përreth.

PROGRES I KUFIZUAR ËSHTË ARRITUR NË :

- Hartimin e planit të zbatimit mbi çështjen e "mbrotjtjes civile" - proces që është në rrjedhë që nga shkurti i vitit 2015.

- Pikë-kalimet e përhershme kufitare të IBM/MIK-ut - BE-ja ka bërë përparime në përpjekjet e kontraktimit të partnerit zbatues.

ZHVILLIMET REGRESIVE:

Në vend të progresit, kjo periudhë raportimi është karakterizuar më tepër me zhvillime negative të krijuara nga Serbia, e cila riktheu mbështetjen për strukturat e saj ilegale paralele në Kosovë, sidomos që nga tetori i vitit 2014 për të vazhduar forcimin dhe zgjerimin e tyre që nga janari i këtij viti.

Mbështetja e Serbisë për strukturat paralele të paligjshme e ka dëmtuar në mënyrë të dramatike progresin e arritur në funksionimin ligjor dhe integrimin e katër komunave veriore në sistemin e Kosovës. Serbia veprroi më tej në kundërshtim të Marrëveshjes së Brukselit duke i udhëzuar komunat që të mos miratojnë buxhetet legale komunale, në përpjekje që të parandaloj sektorët e arsimit dhe shëndetësisë të integrohen në sistemin e Kosovës. Për shkak të ndërhyrjeve të tilla të Serbisë, në tetor të vitit 2014 dhe shkurt të vitit 2015, katër komunat veriore po përballen me bllokim buxhetor që nga 1 marsi i këtij viti. Pasojat e ndërhyrjeve janë akoma më të rënda në kuptimin e dëmtimit të bashkëpunimit në rritje mes të këtyre strukturave lokale dhe autoriteteve qendrore në Kosovë, si dhe në procesin e rikthimit të besimit mes Qeverisë së Kosovës dhe qytetarëve serbë të kësaj pjese të vendit, i rrënuar për shumë vite.

Me shqetësim të thellë konstatojmë se tendencat e rrënimit të progresit të arritur në dialog së bashku me dështimet në zbatimin e marrëveshjeve, shfaqin mungesën e vullnetit të Serbisë për marrëdhënie të mira fqinjësore me Kosovën. Serbia ka vazhduar të paraqes pengesa për anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale, madje edhe në rastet kur Kosova tashmë është bërë anëtare e plotë, etj.

Kemi prirje që këtë periudhë të rezultateve të dobëta në Dialogun e Brukselit ta shohim si një zhvillim të veçantë, dhe sigurisht se presim përparime substanciale drejt niveleve e dinamikave të reja në këtë proces.

Qeveria e Kosovës njih dhe vlerëson lartë kontributin e BE-së si lehtësuese dhe garantuese e marrëveshjeve e cila do të vazhdojë të luajë një rol kyç në punën tonë të përbashkët për përparime të reja në dialog. Gjithashtu, vlerësojmë lartë rolin e SHBA-ve në mbështetjen e plotë të këtij dialogu si dhe rritjen mbështetjes nga Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së.

1. FUNKSIONIMI I BRISHTË I KOMUNAVE VERIORE TË KOSOVËS – I PENGUAR NGA STRUKTURAT ILEGALE

Në vend të progresit në funksionimin legal të katër komunave veriore të Kosovës, në periudhën raportuese është shënuar një brishtësi në funksionim, sepse puna e tyre është dëmtuar në mënyrë dramatike nga strukturat paralele të mbështetura nga Serbia. Që nga tetori i vitit të kaluar, Serbia ka rritur mbështetjen për strukturat e saj paralele në Kosovë, duke vazhduar zgjerimin e tyre në janar të këtij viti.

Serbia më tej ka vepruar në shkelje të marrëveshjes së Brukselit të 19 prillit të vitit 2013, duke i këshilluar komunat që të mos miratojnë buxhetet në përputhje me ligjet e Kosovës, duke u munduar të parandalojnë integrimin e sektorit të arsimit dhe shëndetësisë në sistemin e Kosovës. Si pasojë, katër komunat veriore po përballen me bllokime buxhetore që nga 1 marsi i vitit 2015. Vlen të theksohet se Qeveria e Kosovës ka trefishuar buxhetet për vitin 2015 për ato komuna, duke demonstruar angazhimin e saj për të kompensuar kohën e humbur nga refuzimi i tyre për integrim në sistemin e Kosovës. Pasojat negative të ndërhyrjes së Serbisë janë kanë ndikuar edhe në bashkëpunimin në rritje mes këtyre autoriteteve komunale dhe autoriteteve qendrore në Kosovë si dhe integrimin e përgjithshëm të qytetarëve serbë të kësaj pjese në institucionet e Kosovës. Këto tendenca regresive të shfaqura nga Serbia janë shkelje e marrëveshjes së Brukselit të 19 Prillit të vitit 2013 dhe janë dëmtuese për progresin e bërë deri më tani në normalizimin e situatës në pjesën veriore të Kosovës.

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi e ka informuar BE-në për këto zhvillime negative. Ministrja për Dialog, në letrën e saj dërguar BE-së, ka informuar në detaje në lidhje me këto probleme dhe i bëri thirrje BE-së që të angazhohen duke i kërkuar Serbisë që të zbatojë Marrëveshjen e Brukselit.

Funksionimi ligjor i katër komunave veriore në Kosovë, Mitrovicë të veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq ka qenë rezultat i drejtpërdrejt i marrëveshjes së Brukselit në saje të së cilës këto komuna morën pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Kosovë. Inaugurimi zyrtar i organeve komunale në të katër komunat (11 janar 2014) dhe miratimi i statuteve komunale (16 maj 2014), në përputhje me ligjet e Kosovës siç u kërkuar në Marrëveshjen e Brukselit ka shënuar progres të rëndësishëm në zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Kjo ka shtruar rrugën drejt normalizimit dhe demokratizimit në këtë pjesë të vendit tonë, që ka munguar për shumë vite.

Disa sfida kryesore janë para nesh: miratimi i buxheteve legale nga komunat e lartpërmendura sa më shpejt që të jetë e mundur; krijimi i administratave ligjore komunale; miratimi i simboleve, vulave dhe logove në pajtim me ligjin e Kosovës. Siç është raportuar, kryetarët legjitim të komunave ende ka raste kur përdorin logot dhe vulat e paligjshme komunale. Për shembull, në fillim të këtij viti kemi evidentuar rastin kur komuna e Leposaviqit u përpoq të nënshkruajë një kontratë me Këshillin e Evropës si përfitues i një projekti të veçantë duke përdorur vulat e paligjshme me përshkrimin "Republika e Serbisë - Komuna e Leposaviqit". Një veprim i tillë jo-ligjor është parandaluar.

Qeveria e Kosovës beson se është i nevojshëm ndërmjetësim energjik i BE-së për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të lartpërmendura dhe sfidave të tjera në mënyrë që të nxisë progresin mbi funksionimin normal dhe ligjor të këtyre komunave.

2. STRUKTURAT PARALELE TË SERBISË NË KOSOVË - DUHET TË HIQEN

Serbia vazhdon të ndërhyj në Kosovë përmes ruajtjes së strukturave paralele, në kundërshtim me marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore në mes të dy shteteve.

Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë janë pengesa kryesore në procesin e normalizimit të situatës në pjesën veriore të Kosovës, prandaj shpërbërja e tyre është shumë e rëndësishme për zbatimin efektin të marrëveshjes.

Konsiderojmë që intervenimi i BE-së në këtë çështje është i një rëndësie të madhe në mënyrë që të lejojë progresin e mëtejshëm në dialog dhe në zgjidhjen e çështjeve të mbetura të kësaj marrëveshje.

Sipas dëshmive tona, kryetarët e paligjshëm të komunave janë atë të cilët marrin mbështetjen politike dhe pagesat nga Serbia dhe me kompetencat e tyre joligjore e pengojnë punën e kryetarëve të komunave/kuvendeve komunale të zgjedhura në mënyrë demokratike si dhe e pengojnë punën e tyre ligjore në përputhje me ligjet e Kosovës.

Strukturat paralele komunale dhe personat e emëruar janë: për komunën e Mitrovicës së Veriut, Aleksandar Spiric është emëruar si president i të ashtu quajturës "Organi i

përkohshëm i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Kosovës" (ai gjithashtu është zëvendës kryetar i komunës së Mitrovicës Veriore i emëruar nga kryetari i komunës i përzgjedhur ligjërisht Dragan Rakic). Gjithashtu, janë emëruar anëtarët e këtij organi, përkatësisht Dragisa Vlaskovic, Dragan Radisavljevic, dhe Ninislav Deric. Për komunën e Zveçanit, presidenti i atij organi ligjor është emëruar Vucina Jankovic

(ai gjithashtu është përzgjedhur ilegalisht si kryetar i komunës së Zveçanit në zgjedhjet lokale në Kosovë në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Dragan Nedelković, Ivan Todosijević, Sinisa Milosavljević, Milivoje Galjak dhe Miodrag Acić.

Për komunën e Leposaviqit, si president i këtij organi të paligjshëm është emëruar Dragan Jablanović (ai u zgjodh si Kryetar i Leposaviqit në zgjedhjet e lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Dobrivoj Gjurgjeviq, Zoran Todić, Marka Kuzmanović dhe Radosh Mihajloviq. Për komunën e Zubin Potokut, si president i këtij organi të paligjshëm u emërua Stevan Vulović (ai u zgjodh si Kryetar i Zubin Potokut në zgjedhjet e lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013). Anëtarët e këtij organi janë: Nemanja Jakshiq, Dragisha Jovanović, Bojan Perovic dhe Latinka Utvić. Serbia i ka bërë këto emërimet në strukturat paralele komunale të para zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit të vitit 2013, në Republikën e Kosovës, dhe ende vazhdon t'i mbështesë ato politikisht dhe financiarisht.

Më 31 dhjetor të vitit 2015, Qeveria e Serbisë e emëroi Bratislav Nikolic, kryetarin e zgjedhur ligjërisht të komunës së Shtërpçës në zgjedhjet lokale të Kosovës në nëntor të vitit 2013, në pozitën e kryetarit të ashtuquajturës "organ i përkohshëm komunal" i Shtërpçës. Po kështu, për anëtarët e këtij organi, Serbia emëroi Dragan Vleković, Nenad Filipovic dhe Dragan Redzić.

Së fundmi, më 19 shkurt të vitit 2015, Qeveria e Serbisë miratoi dy vendime në lidhje me të ashtu quajturën "Teatrin Kombëtar të Prishtinës", ku në njërin vendim shkarkohen anëtarët e bordit Marinko Bozovic, Danica Andrejeviq, Dušan Celić, Dzevad Coraj, Vladimir Stanojeviq dhe Gulbehar Šabović dhe në vendimin tjetër emërohen anëtarë e rinj Masha Mihailović Jelena Knezeviq, Dragan Petroviq, Snezhana Zuvić, Dejan Stojanović, Igor Damjanović dhe Vladislav Gjerковиq.

Këto vendime i kanë ndjekur vendimet Qeverisë së Serbisë të 11 shkurtit të vitit 2015 për ndryshimin e Vendimit për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të trupit të përkohshëm në komunat në territorin e Kosovës. Vendimi nuk është i qartë sepse nuk përmban emrat e anëtarëve të caktuar, por vetëm iu referohet vendimeve të viteve 2005,

2007, 2008, 2011, 2012, dhe 2014.

Më 5 shkurt të vitit 2014, Qeveria e Serbisë ka vendosur të emërojë si U.D. të Drejtorit të Qendrës Shëndetësore në Pejë, Stanislava Radoviqin, si dhe U.D. i Drejtorit të Shtëpisë së Shëndetit në Dragash, Xhafcen Sadat. Në të njëjtën ditë ata e morën vendimin për shkarkimin e Sava Stanojeviq nga pozita e ushtruesit të detyrës së drejtorit të "Qendrës Shëndetësore në Pejë".

3. SIGURIA – “MBROJTJA CIVILE”- ende nuk është shuar

Çështja e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile" (MC) ende nuk është zgjidhur, megjithëse negociatat janë duke vazhduar që nga dhjetori i vitit 2013, kur u dakorduan parimet e zbatimit në Bruksel.

Kosova ka treguar interes të vazhdueshëm në përshpejtimin e planit të zbatimit për shpërbërjen e "MC" dhe integrimin e anëtarëve të mëhershëm të kësaj strukture në institucionet e Kosovës. Në përputhje me këtë, Kosova i paraqiti BE-së një plan gjithëpërfshirës për integrim duke ofruar punë për individët e interesuar pas shpërbërjes së "MC".

Megjithatë, Serbia vazhdimisht e ka zvarritur ofrimin e planit për shpërbërjen duke përfshirë rregullimet ligjore që të pushojë zyrtarisht funksionimi i "MC". Rregullimet ligjore nënkuptojnë heqjen e "MC" nga Ligji i Serbisë mbi Mbrojtjen dhe nga organizimi strukturor i Ministrisë së Brendshme të Serbisë.

Në periudhën raportuese, ka pasur pak progres në zhvillimin e projekt-planit për zbatimin ndaj "MC". Negociata intensive me delegacionin e BE-së, i cili erdhi në Prishtinë për këto çështje, janë mbajtur më 26 nëntor të vitit 2014 dhe kanë vazhduar këtë vit më 3, 4 dhe 6 shkurt si dhe 18 mars të vitit 2015. Gjithashtu, delegacioni i BE-së shkoi në Beograd, pasi që pas më shumë se tetë muaj të zvarritjes, Serbia tregoi interes për të diskutuar për këtë temë. Nga këto negociata intensive, ndërmjet delegacionit të BE-së të udhëhequr nga Bernd Thran dhe delegacionit të Kosovës të udhëhequr nga Ministria për Dialog, Edita Tahiri, kemi bërë progres të rëndësishëm në draft planin për zbatim.

Siç jemi dakorduar, plani do të përfshijë tre komponentë: 1. Shpërbërja e strukturave të MC-së, 2. Integrimi i individëve, dhe 3. Rregullimet ligjore të Serbisë.

Shpërbërja e MC

Shpërbërja e të ashtuquajturës MC do të ndjek parimet e dakorduara në takimin e Kryeministrave më 13 dhjetor të vitit 2013. Plani i dakorduar për shpërbërje, parasheh mbylljen e të gjitha objekteve, zyrave dhe depove dhe të gjitha ato do të dorëzohen tek institucionet e Kosovës. Ndërsa largimi i pajisjeve, uniformave dhe të gjitha elementeve do të ndjek modelin e zbatuar në rastin e mbylljes së ish-strukturave paralele serbe të policisë (ish-strukturat e MUP).

Rregullimet ligjore nga Serbia

Serbia është detyruar që të bëjë rregullimet ligjore për shpërbërjen e strukturave të MC-së në Kosovë dhe t'i dorëzojë BE-së dëshmi zyrtare që i konfirmojnë këto veprime ligjore. Gjithashtu, jemi dakorduar që Serbia duhet t'i paraqes BE-së prova zyrtare në lidhje me ndërprerjen e pagave dhe mbështetjes financiare për MC-në, përmes miratimit të rregulloreve të nevojshme (dekretet) për të zbatuar këtë. Serbia duhet të informojë BE-në, me shkrim, se MC në Kosovë nuk ekziston më në sistemin e Serbisë. Palës kosovare duhet t'i paraqiten këto dëshmi zyrtare nga BE-ja.

Siç njoftohet nga BE-ja, Serbia është në proces të ndryshimit të dy ligjeve, Ligjit për Mbrojtjen dhe Ligjin për reagimin emergjent. Kemi kërkuar që Serbia duhet të ndryshojë strukturën organizative të Ministrisë së saj të Punëve të Brendshme duke hequr MC nga kjo strukturë.

Integrimi i ish-anëtarëve të MC në institucionet e Kosovës

Sa i përket integrimit, vitin e kaluar Kosova i ka paraqitur BE-së Planin e Qeverisë së Kosovës për integrimin e ish-pjesëtarëve të MC në institucionet civile të Kosovës. E kemi përditësuar edhe më tej këtë plan, në përgjigje të një qasje më gjithëpërfshirëse të kërkuar nga BE-ja në bisedimet e fundit gjatë muajit shkurt, ku kryesisht e kemi rritur numrin e vendeve të punës që ne mund të ofrojmë për ata individë të cilët do të jenë të interesuar të punësohen në institucionet e Kosovës.

Plani i qeverisë së Kosovës për integrim ofron gjithsej 550 pozita të punës; me ç'rast 400 persona do të integrohen në institucione të ndryshme civile të Kosovës (sipas parimeve dhe afateve të dakorduara të planit të veprimit), 50 prej tyre duhet të përfshihen në listën e pritjes në mënyrë që të integrohen gradualisht brenda periudhës 3 vjeçare, përderisa paguhen nga fondi për kontigjenca, ndërsa deri në 100 persona do të punësohen përmes projekteve të financuara nga fondi për zhvillim. Institucionet e Kosovës në të cilët do të integrohen këta individë janë ministritë dhe agjencitë publike të cilat me ligj kanë aktivitete në nivel lokal. Ata do të rinisnin operacionet e tyre në

katër komunitat veriore (kanë qenë të penguar të bëjnë këtë për shumë vite), duke integruar ish-anëtarët e MC-së. Procedurat e integritit do të jenë në pajtim me Ligjin e Kosovës për Shërbyesit Civil.

Duam të theksojmë se Kosova ka përmbushur detyrimin për numrin e vendeve të punës që ishte dakorduar me BE-në. Në të vërtetë, kemi qenë mjaft bujar në ofrimin e gjithsej 550 vendeve të punës dhe kjo duhet të vlerësohet dhe të shihet si zotim i vërtetë i Qeverisë së Kosovës për të integruar serbët e pjesës veriore në sistemin e Kosovës. Në anën tjetër, pretendimet e palës serbe për listën e 751 personave që priten të integrohen, siç e dimë të gjithë, kanë qenë të ekzagjeruar. Në bisedimet tona të përbashkëta, u konfirmua se 88 prej tyre do të dalin në pension. Për më tepër, e kemi gjetur se 115 prej tyre nuk janë qytetar të Kosovës dhe siç kemi rënë dakord që të gjithë ata që duan të integrohen duhet të dëshmojnë vendbanimin në Kosovë në pajtim me Ligjin e Kosovës. Në letrën që Ministrija Tahiri ja ka dërguar BE/Bernd Thran më 13 mars të vitit 2015, Kosova ka konfirmuar gatishmërinë që të finalizojë zbatimin e planit mbi "MC" së bashku linjat e lartpërmendura.

4. DREJTËSIA –marrëveshja është arritur – pritet të filloj zbatimin

Në çështjet e drejtësisë, progres është bërë me arritjen e Marrëveshjes për zbatimin në drejtësi, në takimin e Kryeministrave dhe PS Mogherini në Bruksel më 09-10 shkurt të vitit 2015. Marrëveshja për zbatimin e drejtësisë parashikon zbatimin e legjislacionit të Kosovës dhe funksionimin e sistemit unitar të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës, si dhe themelimin e një Gjykate Themelore dhe një Zyre të Prokurorisë Themelore për rajonin e Mitrovicës (që mbulon shtatë komuna) në pajtim me ligjin e Kosovës mbi gjykatat themelore. Plani parashikon në detaje procedurat e integritit të gjykatësve dhe prokurorëve serbë në institucionet e drejtësisë të Kosovës, në pajtim me ligjin e Kosovës. Aspektet konkrete të detajuara përfshijnë: kryetari i gjykatës themelore do të jetë serb, ndërsa udhëheqësi i prokurorisë do të jetë shqiptar; Përbërja etnike; akomodimi i këtyre mekanizmave në ndërtesat; degët e gjykatave në Zubin Potok dhe Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri, etj.

Qeveria e Kosovës i bëri thirrje BE-së që të përshpejtojë procesin e zbatimit në terren dhe të mos lejojë vonesat e përjetuara deri tani në fushat tjera të marrëveshjeve të Brukselit. E mirëpresim zbatimin efektiv të kësaj marrëveshjeje që do të hapë rrugën për konsolidimin e sistemit unitar të drejtësisë në Kosovës në pjesën veriore të vendit tonë

si dhe integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serb në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Pas shumë vitesh, kjo do ti jep fund strukturave paralele serbe në fushën e drejtësisë, që janë shpërbërë në shtator të vitit 2013, por që vonesat në integrim kanë krijuar situata të paqarta. Më 18 shkurt 2015, lehtësuesi i BE-së Alexis Hupin u takua me Ministrin e Drejtësisë së Kosovës, Hajredin Kuçi në lidhje me procedurat dhe afatet për këtë çështje. Më 25 mars 2015, autoritetet përkatëse të Kosovës do të publikojnë konkursin në lidhje me qëllimet e integritit.

Si shënim përkujtues, i gjithë procesi i zbatimit është zhvilluar në dy faza. Në fazën e parë (maj-shtator 2013) është arritur marrëveshja mbi shuarjen e strukturave paralele serbe të drejtësisë në Kosovë. Ato janë shpërbërë dhe verifikuar nga EULEX-i në shtator të vitit 2013, megjithëse ndonjëherë janë dhënë informata konfuzive në lidhje me këtë çështje duke marrë parasysh se po vonohej procesi i krijimit të strukturave legale. Në fazën e dytë (Dhjetor 2013 - Shkurt 2015) u arrit marrëveshja mbi vendosjen e sistemit unitar të drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës si dhe integrimi i individëve serb (gjyqtarë dhe prokurorë) në institucionet e drejtësisë së Kosovës.

5. BARRIKADA NË URËN E MITROVICËS – po vonohet largimi

Heqja e barrikadës nga ura e Mitrovicës dhe të tjerave përreth është duke u vonuar. Marrëveshja e arritur në Bruksel më 22 korrik të vitit 2014, ka përcaktuar që BE-ja ta heq atë përmes re-vitalizimit të urës. Gjithashtu, ishte paraparë të hiqen pengesat e tjera përreth. Ministrja Tahiri, nga arritja e marrëveshjes, vazhdimisht i kërkoi BE-së të përshpejtojë largimin për shkak të stabilitetit në atë pjesë. Gjithashtu, më 9 shkurt të vitit 2015, kjo çështje u ngritë nga Kryeministri Mustafa në takim me PL Mogherini.

Në takimin mes ministres Tahiri dhe PSBE, Zbogor më 18 mars të vitit 2015, janë diskutuar sërish hapat dhe afatet kohore. BE/PSBE ka premtuar të lëvizë shpejtë në dizajnimin e planit të revitalizimit dhe të fillohet procesi brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh. Procedurat për zbatim do të diskutohen dhe dakordohen në takimin e ardhshëm në Bruksel.

6. ASOCIACIONI

Çështja e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë mbetet të diskutohet në të ardhmen. Diskutimi do të fokusohet në zhvillimin e planit të zbatimit (statuti i asociacionit).

Asociacioni do të ndjek modelin e asociacionit ekzistues të komunave në Kosovë, duke u bazuar në ligjet ekzistuese të Kosovës të kërkuara nga Marrëveshjet e Brukselit e 19 prill 2013. Në përputhje me ligjin e Kosovës, Asociacioni nuk mund të ketë kompetenca ekzekutive dhe as mbikëqyrëse.

Qëndrimi i Kosovës është që diskutimet mbi çështjen e asociacionit mund të bëhen vetëm kur të plotësohen kushtet e nevojshme. Këto kushte janë:

1. Shpërbërja e të gjitha strukturave paralele të Serbisë në Kosovë
2. Zbatimi i Marrëveshjes për drejtësinë
3. Shpërbërja e të ashtuquajturës mbrojtje civile
4. Largimi i barrikadës në urën e Mitrovicës dhe të tjerave përreth.

Qeveria e Kosovës ia ka paraqitur qëndrimin e saj BE-së në shumë takime.

7. TELEKOMUNIKACIONI – KODI TELEFONIK I KOSOVËS – nuk ka progres

Nuk ka progres në zgjidhjen e kodin telefonik ndërkombëtar për Kosovën. Kjo çështje është e ndërlidhur me disa rishikime që duhet të bëhen nga Kosova mbi përmbajtjen e draft-tekstit të vendimit të ITU-së për kodin e Kosovës dhe përmbajtjen e draft-letrës për aplikim të Austrisë në emër të Kosovës. Qëndrimi i Kosovës është që këto dy dokumente duhet të jenë në përputhje me marrëveshjen e Brukselit mbi telekomunikacion të 8 shtator 2014. Qëndrimi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë se letrat duhet të jenë politikisht korrekte dhe të mos jenë paragjyquese. Pas insistimit nga ana e Kosovës, përmbajtja e vendimit të ITU-së ka pësuar ndryshime cilësore dhe mund të jetë i pranueshëm nëse edhe letra e Austrisë ndryshohet në disa pjesë, sipas kërkesave tona. Përndryshe, opsioni i tjetër do të ishte që letra e vendimit të ITU në përmbajtje duhet të i referohet marrëveshjes së Brukselit mbi telekomunikacion të datës 8 shtator 2013.

8. ENERGJIA – progres i mirë në disa aspekte, bllokim në disa të tjera

Sa i përket energjisë, ka pasur progres në disa aspekte ndërsa në disa të tjera është bllokuar. Procesi i zbatimit është bllokuar për shkak të tendencave të Serbisë që një ndërmarrje e re e regjistruar në Kosovë të ketë edhe kompetenca të distribucionit të energjisë, e që është në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit. Sipas Marrëveshjes së Brukselit për energjinë, ndërmarrja e re nuk mund të ketë kompetenca për distribucion të energjisë. Po ashtu, autoriteteve të Kosovës ende nuk iu është dorëzuar kontrolli mbi nënstacionin e Vallaçit, gjë që pengon normalizimin e situatës së energjisë në pjesën veriore të Kosovës. Në aspektet e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të

transmisionit të dy shteteve, përkatësisht KOSTT dhe EMS, është bërë progres i mirë në nënshkrimin e dy marrëveshjeve:

8.1. Marrëveshja kornizë ndërmjet KOSTT-EMS

Marrëveshja kornizë që rregullon operimin dhe marrëdhëniet tregtare ndërmjet KOSTT (Kosovës) dhe EMS (Serbisë) është nënshkruar më 12 shkurt 2014, e cila është e detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy operatorëve të sistemit të energjisë elektrike. Sipas dispozitave të saj, do të bëhen rregullime të mëtejshme për të siguruar që KOSTT të bëhet një bllok i pavarur rregullues si pjesë e ENTSO-E dhe merr pjesë në mekanizmin Evropian të kompensimit ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit (ITC). Marrëveshja gjithashtu ka gjasa ti jap fund mosmarrëveshjes së gjatë ndërmjet Sekretariatit dhe Serbisë në rastin e ECS-3/08 dhe ka për qëllim të përfundojë mosmarrëveshjen ndërmjet KOSTT dhe EMS në rastin e ankesës së KOSTT kundër Serbisë, të paraqitur në Sekretariatit e Komitetit, i njohur si rasti ECS-8/3.

8.2. Marrëveshja operacionale ndërmjet KOSTT-EMS

KOSTT (Kosovë) dhe EMS (Serbia) kanë nënshkruar, më 14 shtator 2014, të njohur si Marrëveshje Inter-TSO për menaxhimin e rrjetit dhe operimin e sistemit. Marrëveshja Inter-TSO dhe Shtojcat e saja teknike përfshijnë bazën ligjore dhe teknike për funksionimin e pavarur të sistemeve të energjisë elektrike të vendeve përkatëse. Hapi tjetër është arritja e marrëveshjeve tjera në lidhje me kompensimin e humbjeve në të kaluarën, përdorimin e rrjetit horizontal si rezultat i tranzitit dhe alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit. Për më tepër, kjo marrëveshje parasheh që KOSTT dhe EMS do të veprojnë si dy blloqe të pavarura rregulluese që plotësojnë kërkesat e ENTSO-E, pranimin e KOSTT-it si një zonë rregulluese (Zonë e Kontrollit) dhe anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit).

8.3. Problemet në hidrocentralin e Ujmanit

Më 5 Mars 2015, Ministria për Dialog, Edita Tahiri, mori një njoftim urgjent nga Drejtori i Hidrondërmarrjes "Ibër-Lepenc" për ndaljen e parregullt të punës në hidrocentralin e Ujmanit/Gazivodës nga drejtori paralel, z. Srdjan Vulovic. Ministria Tahiri menjëherë kërkoi ndërmjetësim nga BE-ja/Nicholas Cendrowicz për ta zgjidhur këtë çështje. Në saje të BE-së, menjëherë pas disa orëve problemi ishte zgjidhur dhe hidrocentrali kishte rifilluar punën, duke shmangur rreziqet e rritjes së pakontrolluar të rezervuarit të ujit. Puna po vazhdon edhe sot sipas planit të rregullt, megjithatë ekzistenca e strukturave paralele krijon pasiguri në funksionimin e tij.

9. IBM – NDËRTIMI I OBJEKTEVE TË PËRHERSHME – ka nevojë për përshpejtim

Sa i përket ndërtimit të pikëkalimeve kufitare të përherëshme të IBM ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ministrja Tahiri i ka shkruar BE-së/kryetarit të GI të IBM më 9 mars 2015, duke u bërë thirrje për të përshpejtuar procesin e zbatimit. Në këtë letër nga BE-së është informatë mbi procesin e kontraktimit të një partneri implementues, ndërkohë Kosova ka njoftuar se ka plotësuar detyrimet e saj lidhur me përgatitjet për ndërtimet dhe Plani i Veprimit i është prezantuar PSBE më 27 nëntor 2014.

Plani i Veprimit i Kosovës përbëhet nga një numër i masave specifike, duke përfshirë veprimet dhe afatet kohore të cilat secila palë ka nevojë t'i ndërmarrë me qëllim të zbatimit. Këto masa janë: shpronësimi i tokës ku do të ndërtohen PK-të e IBM; verifikimi nëse ka plane rregulluese urbane për vendet ku do të ndërtohen PK-të e IBM; dhënia e lejeve të ndërtimit për PK-të e IBM; verifikimi i gjendjes dhe kushteve të infrastrukturës mbështetëse (energjisë elektrike, ujit, kanalizimit dhe telefonit); përcaktimi se cilat ndërtesa duhet të largohen ose të shkatërrohen në zonë; përcaktimi se cilat masa të përkohshme duhet të merren për të mirëmbajtur funksionimin e PK-ve ekzistuese të IBM deri në ndërtimin e ndërtesave të reja, etj.

BE-ja u informua gjithashtu se në javët e ardhshme Kosova planifikon të fillojë me kërkesën për shpronësimin e tokës, një proces që do të kërkojë tre deri në katër muaj që të përfundohet. Sa i përket planifikimit urban dhe lejeve të ndërtimit, këto do të lëshohen nga MMPH-ja pasi që kontraktuesi të ketë përgatitur një dizajn të detajuar dhe të aplikojë për leje të tilla.

Në mënyrë që të jetë në gjendje të lëvizë në këtë drejtim, ministrja Tahiri shpjegoi se ne duhet të kemi një reagim nga BE-ja në lidhje me kohën e duhur e cila është e lidhur me procesin e përfundimit të kontratës për ndërtimet nga ana e BE-së.

Ministrja Tahiri ka shprehur shqetësimet e saja për vonesat në procesin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet BE-së dhe partnerit implementues UNOPS (pasi që kanë kaluar pothuajse katër muaj që nga fillimi i këtyre negociatave).

Më 13 mars 2015, ministrja Tahiri u takua me PSBE Zbogar, për të diskutuar në lidhje me këtë çështje me qëllim të përshpejtimit të zbatimit. Më 18 mars 2015, bisedimet vazhduan në këtë çështje me BE/Bernd Thran, të cilat përfunduan me zotimin e përbashkët për të çuar përpara zbatimin.

Përveç përshpejtimit të ndërtimit të objekteve të IBM, në përgjithësi mund të thuhet se

Marrëveshja e IBM dhe Protokollit Teknik janë duke u zbatuar në nivel të kënaqshëm. Autoritetet e IBM nga të dyja vendet po ndjekin bashkëpunim më të ngushtë, në përputhje me standardet evropiane. Kjo mund të shihet përmes takimeve të rregullta të nivelit lokal, rajonal dhe qendror. Takimi i IBM i nivelit qendror, që është mbajtur në Prishtinë më 12 mars 2015, është vlerësuar si një aktivitet konstruktiv nga autoritetet e BE-së.

Shënim përkujtues: Më 4 shtator 2014 në Bruksel, pas një viti negociatash, u arrit dhe u nënshkrua marrëveshja për ndërtesa të përhershme nga të tri palët, Kosova, Serbia dhe BE-ja. Kjo ka shënuar një progres thelbësor drejt zbatimit të plotë të Marrëveshjes së IBM dhe Protokollit Teknik. Marrëveshja parasheh ndërtimin e pikëkalimeve të përhershme kufitare të IBM, duke ndjekur dizajnin dhe lokacionin e dakorduar dhe në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira Evropiane. Komisioni Evropian/DP për Zgjerim ka alokuar një fond prej rreth 21 milion Euro dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha procedurat për planifikim dhe ndërtim. Fondi, i përbërë nga fondet e IPA të të dyja shteteve, tashmë është caktuar dhe do të alokohet zyrtarisht në tetor të vitit 2014.

9.1. Certifikatat fitosanitare

Në mënyrë të ngjashme, pas pothuajse një viti negociatash është arritur marrëveshja për Certifikatën Veterinare mbi ushqimin e kafshëve, në takimin e mbajtur me 5 shtator 2014, krahas Certifikatës Fitosanitare e cila ishte dakorduar në një fazë më të hershme të bisedimeve. Si hap të ardhshëm, të dyja palët do të zgjerojnë modelin dhe gjuhën e miratuar për Certifikatat Veterinare për eksportimin e bagëtive.

9.2. SEED

Shkëmbimi elektronik i informacioneve përmes SEED ka shkuar mirë. Kjo zhvillohet si një shkëmbim i pjesshëm i informacioneve prandaj janë hulumtuar mundësitë për një shkëmbim të plotë të informacioneve. Kjo është e dobishme për të dyja Administratat Doganore për të mbështetur më mirë luftën kundër mashtrimit dhe lehtësuar tregtinë. Më 26 dhjetor 2014, lehtësuesi i BE-së/Bern Thran ka propozuar gjuhën reciprokisht të pranueshme në zgjidhjen e kësaj çështje. Pala e Kosovës i ka konfirmuar BE-së më 5 janar 2015 (nëpërmjet emailit) që ne mirëpresim propozimin e BE-së. Megjithatë, pala Serbe është duke vonuar pranimin për gati tre muaj.

10. SIGURIMI I AUTOMJETEVE – nuk ka progres në arritjen e marrëveshjes

Marrëveshja për sigurimin e automjeteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ende në pritje, përkundër asaj se është duke u negociuar për gati dy vite. Kosova ka konfirmuar pranimin në dhjetor të vitit 2014, ndërsa Serbia është vonuar në pranimin deri më sot. Nënshkrimi i Marrëveshjes, i planifikuar të bëhej fillimisht nga mesi i janarit dhe pastaj për 24 mars 2014, është anuluar përsëri nga pala Serbe më 20 mars 2015

Janë zhvilluar disa takime në format dypalësh dhe trepalësh që nga nëntori i vitit 2014 në përpjekje për të arritur këtë marrëveshje të negociuar gjatë. Më 4 nëntor 2014 u zhvillua një takim në Bruksel ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe lehtësuesve të BE-së, duke përfshirë përfaqësuesin e Këshillit të Byrove (CoB). Në këtë takim është dakorduar në parim draft marrëveshja (Marrëveshja e mirëkuptimit – MM) ndërmjet palëve si dhe janë zgjidhur dhe dakorduar çështjet të cilat kanë mbetur të pazgjidhura për shumicën e vitit 2014. Bazuar në rezultatin e takimit në Bruksel, draft MM i është prezantuar industrisë së sigurimeve, përfshirë Asamblesë së Byrosë së Sigurimeve në Kosovë. Në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2014 ndërmjet Asamblesë së Byrosë së Sigurimeve, delegacionit të Kosovës për dialog dhe përfaqësuesve të BE-së dhe CoB, është miratuar draft marrëveshja/MM nga Asambleja e Byrosë së Sigurimeve të Kosovës. Rrjedhimisht, Kosova respektivisht Byroja Kosovare e Sigurimeve zyrtarisht ka konfirmuar pranimin e draft-marrëveshjes pranë BE dhe CoB.

Në anën tjetër, Serbia/Shoqata e Sigurimeve të Serbisë nuk e kanë pranuar këtë marrëveshje deri më tani. Në dhjetor të vitit 2014, pas pranimin nga Kosova, Serbia doli me kërkesa shtesë për miratimin e masave zbatuese që do të përfshiheshin në Shtojcën e draft-marrëveshjes. Pas negociatave të zhvilluara për këtë çështje në takimin trepalësh në Bruksel, u arrit marrëveshja edhe për këtë çështje, dhe mbeti vetëm të caktohej data e nënshkrimit. Ka qenë me të vërtetë frustruese shtyrja për disa herë e datës së nënshkrimit nga Serbia, duke filluar nga mesi i janarit të vitit 2015 deri në shtyrjen e fundit më 24 mars 2014, e cila sërish ishte anuluar nga Serbia.

MM bazohet në shembujt e mëparshëm, të cilët Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) i ka nënshkruar me vende tjera (shembulli i Maqedonisë) dhe në përgjithësi lehtësohet dhe garantohet nga CoB, me garanci të mjaftueshme të ofruar nga autoritetet përkatëse të Kosovës. Ai parasheh lëvizjen e lirë të automjeteve me tarifa shumë më të lira, duke përdorur MTPL Serbe për automjetet e regjistruara të Serbisë dhe MTPL Plus për automjetet e regjistruara të Kosovës dhe ishte paraparë të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2015.

11. BASHKËPUNIMI RAJONAL - progres i mirë, edhe pse vazhdojnë pengesat nga Serbia

Është bërë përparim i rëndësishëm në procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat relevante rajonale, ku Kosova ka fituar statusin e plotë të anëtarësimit. Këto organizata janë: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), ReSPA dhe së fundi anëtarësimi në Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC) më 15 tetor 2014 dhe Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë, më 29 nëntor 2014.

Megjithatë, pengesat e Serbisë vazhdojnë jo vetëm në anëtarësimin e Kosovës por edhe në disa raste edhe ku Kosova tashmë është anëtare e barabartë.

Pengesat janë identifikuar edhe gjatë takimeve të iniciative rajonale, ku ka raste që Kosova nuk ftohet fare apo përballet me vështirësi gjatë këtyre aktiviteteve. Disa nga shembujt janë: në një takim rajonal të organizuar nga Aviacioni Civil i Serbisë, i cili është zhvilluar në Beograd më 22-23 janar 2015, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës nuk ishte ftuar; në takimin rajonal "Ekzaminimi dhe Zbulimi në Kufi - Njerëzit, Automjetet dhe Ngarkesat" që u zhvillua në Kroaci më 9 -13 shkurt 2015, Kosova nuk ishte ftuar; delegacioni nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, gjatë kthimit në Kosovë pas përfundimit të punëtorisë "Metadate dhe Shpërndarja e të Dhënave Hapësinore" që u mbajt në Beograd nga 16-18 dhjetor 2014, u ndalua nga policia Serbe në pikëkalimin kufitar Merdare, ku ata u intervistuan për dy orë (në lidhje me incidentin e Dronit që ka ndodhur gjatë lojës së futbollit ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë).

Pengesat e tilla janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit Rajonal dhe e shkelin atë. Edhe pse Kosova është anëtare e RACVIAC, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është ftuar të marrë pjesë në aktivitetet parlamentare të RACVIAC/MAG. Për më tepër, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është përfshirë, madje as nuk është ftuar të marrë pjesë në aktivitetet e Forumit Parlamentar në Cetinje, Dimensionit Parlamentar të Nismës Adriatiko-Joniane, Asamblesë Parlamentare të Bashkimit Mesdhetar, IPU - Bashkimit Ndër-parlamentar, OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Takimi rajonal i Komiteteve për Punë të Jashtme dhe Fondacioni Westminster për Demokraci.

Kohët e fundit, në seancat e Komisionit për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Siguri të Asamblesë Parlamentare të SEECP, që u zhvilluan më 09-10

shkurt 2015 në Stamboll, Delegacioni i Serbisë në Asamblenë Parlamentare paraqiti disa ndryshime në draft dokumentin, duke kërkuar ndryshimin në formulimin nga "pjesëmarrësit e SEECP" në "SEECP, shtetet pjesëmarrëse dhe Kosova *", duke lënë të kuptohet se Serbia do që Kosova të trajtohet si mysafire e veçantë dhe jo si pjesëmarrëse me të drejta të barabarta. Kjo ka paraqitur shkelje të dyfishtë, së pari në Marrëveshjen e Brukselit mbi bashkëpunimin dhe përfaqësimin rajonal dhe së dyti në Vendimin e SEECP që ka pranuar Kosovën si anëtare të plotë të saj, i cili është votuar edhe nga Serbia.

12. ZYRAT NDËRLIDHËSE

Është bërë progres i mirë në avancimin e përgjegjëseve të Zyrtarëve Ndërlidhës në administrimin e kërkesave për vizitat zyrtare ndërmjet dy shteteve. Më 14 nëntor 2014 u arrit marrëveshja mbi rregullimet dhe modalitetet specifike për vizitat zyrtare ndërmjet përfaqësuesve nga të dyja vendet. Me këtë marrëveshje, të dy Zyrat Ndërlidhëse, Zyra e Republikës së Kosovës në Serbi dhe Zyra e Republikës së Serbisë në Kosovë, do të jenë përgjegjëse për administrimin e vizitave zyrtare të shteteve përkatëse.

Kërkesat për vizita janë bërë më parë përmes zyrave të BE-së në të dyja vendet dhe janë transferuar direkt tek Zyrtarët Ndërlidhës. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2014 dhe disa vizita janë administruar në përputhje me marrëveshjen, duke përdorur kanale të drejtpërdrejta dhe duke respektuar të gjitha dispozitat e marrëveshjes.

Gjithashtu, palët janë dakorduar që të kenë staf shtesë në të dyja zyrat përkatëse (një për secilën). I mbetet delegacionit të BE-së në të dyja vendet që të vendos nëse ata do të mund të ofrojnë nga një zyre shtesë për të plotësuar këtë kërkesë.

Zbatimi i Marrëveshjes për Zyrat Ndërlidhëse ende ka çështje në pritje, siç janë vulat zyrtare të Zyrave përkatëse të Ndërlidhjes, të cilat ende operojnë pa vula.

Në takimin e fundit të zhvilluar në Bruksel më 7 mars 2014, pozicioni i palëve ka qenë si në vijim: Pozicioni i Kosovës ishte se vula duhet të jetë e njëjtë si ajo e misioneve diplomatike të Kosovës në gjithë botën, me stemën e Republikës së Kosovës dhe me tekstin në vijim: Zyra Ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi. Pala serbe ka paraqitur pozicionin e saj se vulat duhet të jenë pa simbole dhe me tekstin në vijim: Zyra Ndërlidhëse në Prishtinë (për Zyrën e Serbisë në Kosovë) dhe Zyra Ndërlidhëse në Beograd (për Zyrën Ndërlidhëse të Kosovës në Serbi). Dallimi i palëve në lidhje me vulat mbetet i pazgjidhur.

Po ashtu, ende nuk është arritur marrëveshje në lidhje me ballinën e letrave dhe

dokumenteve zyrtare. Në takimin e fundit trepalësh, palët arritën mirëkuptimin që formulimet dhe pamjet e ballinës së letrës të jenë të njëjta sikurse ato që do të përcaktohen për vula.

13. MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE

Zbatimi i Marrëveshjes për këtë çështje është duke shkuar mirë. Mbledhja e të hyrave doganore në pikëkalimet kufitare veriore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht Jarinjë dhe Bërnjak, është duke u bërë në përputhje me ligjin e Kosovës. Sipas raportit të Doganës së Kosovës, që nga fillimi i zbatimit (më 14 dhjetor 2013), procesi i përgjithshëm i mbledhjes së të hyrave në këto dy pikëkalime kufitare ka rezultuar me mbi 5 milionë Euro deri më sot. Të hyrat e mbledhura janë duke u transferuar rregullisht në Fondin për Zhvillim, sipas marrëveshjes.

13.1. Licencimi i mallrave të kontrolluara për kompanitë që operojnë në veri të Kosovës

Gjatë periudhës raportuese është shënuar progres i mirë në lidhje me licencimin e mallrave të kontrolluara për kompanitë që operojnë në veri të Kosovës. Duke filluar nga 1 janari 2015, po zbatohet regjimi i licencimit për importin e të gjitha mallrave të kontrolluara që vijnë përmes PK të IBM, Jarinjë dhe Bërnjak, në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

Gjithashtu janë organizuar takime intensive konsultative ndërmjet institucioneve përkatëse të Kosovës me pronarët e kompanive dhe përfaqësues të sektorit të biznesit nga pjesa veriore e Kosovës në lidhje me procesin dhe çështjet tjera që ndërlidhen me procedurat doganore për import/eksport dhe procesin e licencimit. Vlen të theksohet se klima e respektit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit mes tyre është duke u rritur çdo ditë. Gjatë kësaj faze, Dogana e Kosovës, ZAMV dhe agjencitë tjera kanë punuar ngushtë me kompanitë nga veriu, duke iu shpjeguar atyre nevojat dhe modalitetet për licencim dhe kjo është përfunduar më 31 dhjetor 2014. Deri më tani, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës ka lëshuar 88 licenca, Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale 5, ndërsa MTI 9.

Sa i përket procesit të regjistrimit në ZAMV të kompanive që operojnë në komunitat veriore të Kosovës, 633 biznese private janë regjistruar në sistemin e Kosovës që nga data 23.04.2013 kur është nënshkruar MM me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me qëllim të ofrimit të mundësisë dhe qasjes për qytetarët që kërkojnë këtë shërbim.

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje jo vetëm që ka ndihmuar në vendosjen e sundimit të ligjit në këtë fushë dhe reduktimin e ekonomisë joformale, por gjithashtu ka siguruar një burim shtesë për investime zhvillimore në pjesën veriore, për të cilën Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar.

14. FONDI PËR ZHVILLIM

Fondi për Zhvillim, i themeluar në dhjetor të vitit 2014, ka tashmë mbi 5 milionë Euro, të cilat janë mbledhur nga të hyrat në dy pikëkalimet kufitare veriore, Jarinjë dhe Bërnjak.

Mbeten të dakordohen kriteret dhe procedurat për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillim.

Bordi i Fondit për Zhvillim, i përbërë nga Shefi i zyrës së BE-së/PSBE, Ministri i Financave i Kosovës dhe një përfaqësues Serb nga komunat veriore, pritet të takohet gjatë këtij muaji për të aprovuar kriteret dhe procedurat për financimin e projekteve.

15. LIRIA E LËVIZJES

Sa i përket Lirisë së Lëvizjes, në përgjithësi zbatimi ka qenë i kënaqshëm gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, ekzistojnë disa çështje që duhet të zgjidhen, për të siguruar lëvizje plotësisht të lirë, siç janë: heqja e barrikadës në urën e Mitrovicës dhe pengesave tjera të mbetura, marrëveshja e sigurimit të automjeteve në kufi e cila mbetet për t'u nënshkruar pa vonesa të mëtejshme nga ana e Serbisë, si dhe herë pas here lindin probleme të papritura nga shkelja e marrëveshjes nga ana e Serbisë.

Kohët e fundit kemi hasur në një shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga ana e Serbisë, me rastin kur Serbia aplikoi disa masa të njëanshme më 7 mars 2015, me të cilat bllokoi kalimin e lirë të autobusëve dhe kamionëve nga Kosova në Serbi, në dy pikat kufitare, Merdare dhe Dheu i Bardhë. Serbia e ka justifikuar këtë në bazë të vendimit të Ministrisë Serbe të Transportit që çdo autobus dhe kamion që hyn në Serbi duhet të ketë kalibrim të tahogرافit.

Kosova ka kërkuar menjëherë ndërhyrjen e BE-së për të zgjidhur këtë problem. Pas dy orësh, falë ndërhyrjes së BE-së, problemi u zgjidh dhe Serbia pezulloi këto masa.

Kosova pohon se çfarëdo masash të reja që duhen aplikuar në kuadër të kësaj çështje nga cilado palë, duhet të jenë në përputhje me Marrëveshjen, ndërsa, në qoftë se ka masa të tilla që nuk janë përfshirë në marrëveshje atëherë duhet dakordim paraprak nga palët në Bruksel.

Vlerësojmë si progres të mirë hapjen e pikëkalimeve të reja tranzite për vendet e treta nga Serbia, pasi që për qytetarët e Kosovës ka qenë një progres i mirë në avancimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes. Kjo marrëveshje siguron qarkullimin e lirë tranzit për qytetarët e Kosovës në aeroportet e Beogradit dhe Nishit, si dhe kalimin tranzit tokësor përmes Serbisë në vendet e treta, duke përfshirë edhe pikëkalimet kufitare të dyta në Kroaci dhe Hungari dhe hapjen e pikëkalimeve kufitare tranzit për Bullgarinë dhe Maqedoninë. Edhe pse shumica e pikëkalimeve kufitare tokësore kanë funksionuar relativisht mirë, shfrytëzimi i aeroporteve ka funksionuar me vështirësi. Ne kemi marrë informacione nga qytetarët e Kosovës se personeli i aeroportit nuk është i informuar sa i përket marrëveshjes prandaj ata paraqesin vështirësi për qytetarët e Kosovës në udhëtimet e tyre përmes dhe nga aeroportet (kryesisht në aeroportin e Beogradit).

Ne kemi prezantuar në BE një propozim për hapjen e një pikëkalimi të ri kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në portën e quajtur "Kapia," e cila lidh qytetet përkatëse të Kamenicës dhe Medvegjës. Kjo do të shkurtojë distancën e udhëtimit ndërmjet dy qyteteve për më shumë se 100 km, duke lehtësuar më tej lëvizjen e lirë.

16. TREGTIA E LIRË

Zbatimi i Marrëveshjes për tregtinë e lirë (vulat doganore) është duke shkuar mjaft mirë. Herë pas here janë identifikuar shkelje të marrëveshjes nga ana e Serbisë në përdorimin e vulave të paligjshme dhe provokative (në PKK Merdare dhe PKK Dheu i Bardhë), si dhe tatimin e dyfishtë.

Serbia nuk ka hequr akoma doganat paralele nga strukturat e saj. Skema e strukturës organizative të Administratës Doganore të Serbisë ende përfshin zyrën doganore të Prishtinës. Kjo mund të shihet në linkun në vijim:

<http://www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx>

Me përdorimin e këtij lloji të vulave të paligjshme nga institucionet paralele, Serbia shkel marrëveshjen e vulave doganore dhe konkluzionet shtesë/përfundimtare të datës 16 shtator 2014, të arritur në Bruksel. Në pikën 2 të konkluzioneve thuhet se: "Pala e Beogradit dha indikacione se pamja e vulave doganore do të shqyrtohet brenda një muaji në mënyrë që të sigurohet përdorimi i emërtimit në përputhje me marrëveshjen e arritur më 17 janar 2013".

16.1 Tatimi i dyfishtë

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur disa raste të tatimit të dyfishtë, pavarësisht se Serbia ka premtuar që do të respektoj Marrëveshjen. Pala Serbe, në takimin e fundit që u zhvillua në Bruksel më 18 mars 2014, rikonfirmoi BE-së angazhimin e saj për të mos vazhduar me tatimin e dyfishtë.

17. LIGJI PËR AMNISTINË

Kosova ka miratuar Ligjin për Amnistinë më 17 shtator 2013 dhe ky ligj është duke u zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e integritit të qytetarëve Serbë në institucionet e Kosovës, siç parashihet me Marrëveshjen e Brukselit.

18. KASDASTRI – ka pasur progres nga të dyja palët

Ka pasur një progres të kufizuar nga të dyja palët.

Qeveria e Kosovës, më 5 shkurt 2015, ka miratuar Projektligjin e ri për agjencinë e re teknike, Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe e ka proceduar këtë projektligj për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Siç është raportuar, Delegacioni i BE-së në Beograd i ka dhënë një grant Autoritetit të Gjeodezisë të Republikës së Serbisë (RGA) në Beograd për të skanuar dokumentacionin kadastral të kërkuar nga Marrëveshja e Dialogut. Në tetor të vitit 2014, zyra ka elaboruar një shtesë për grantin e RGA-së, me qëllim për të përshtatur buxhetin me situatën e indeksimit të kadastrit dhe për të shtuar 6 muaj tjerë për përmbushjen e objektivit të kontratës.

Sipas raportit të fundit nga zyra e PSBE/BE-së në Kosovë, Delegacioni i BE-së në Beograd po financon një Ekip për Asistencë Teknike (EAT) për të ndihmuar RGA Serbe në menaxhimin e grantit dhe për të funksionuar si një ndërlidhës ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Zyra e PSBE në Kosovë luan një rol lehtësues dhe në mënyrë aktive merr pjesë në mbledhjet e Komitetit Drejtues të projektit.

Deri më tani janë skanuar rreth 12,5% për qind e dokumenteve. Në shifra konkrete, janë skanuar 1.548.000 faqe nga gjithsej 12 milionë, duke përdorur instalimet ekzistuese.

19. DIPLOMAT – nuk është zbatuar nga Serbia

Lidhur me çështjen e njohjes reciproke të diplomave universitare nuk ka pasur fare progres nga pala Serbe. Pavarësisht se certifikimi ndërkombëtar i diplomave është kryer nga Asociacioni Evropian i Universiteteve (AEU) për rreth 300 aplikime, Serbia nuk ka njohur ndonjërin prej tyre deri më sot.

20. REGJISTRI CIVIL

Zbatimi i kësaj marrëveshje është përfunduar me sukses. Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin Danez për Refugjatë, ka filluar zbatimin e projektit të financuar nga BE-ja për digjitalizimin e kopjeve të vërtetuara të librave të regjistrimit civil, të kthyera nga Serbia në Kosovë. Ata tashmë janë në fillim të zbatimit të projektit dhe sapo kanë publikuar njoftimin për hapjen e vendeve të punës për 15 monitorues për futjen e të dhënave dhe 100 operatorë të futjes së të dhënave për të mbështetur procesin e digjitalizimit të regjistrimit civil

Lista e shkurtesave

PKK - Pikëkalim Kufitar
DP - Departamenti për Zgjerim i Komisioni Evropian
SEED - Sistemi Elektronik i Shkëmbimit të të dhënave në Ballkanin
Perëndimor
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
MC - Mbrojtja Civile
EEAS - Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
EMS - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut i Serbisë
BE - Bashkimi Evropian
AEU - Asociacioni Evropian i Universiteteve
EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PL - Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian
IBM - Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK)
GI - Grupi Implementues
KEDS - Kompania për Distribucion dhe Furnizim të Energjisë Elektrike në Kosovë
KOSTT - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
PK - Policia e Kosovës
AKVVK - Agjencia Kosovare për Krahasimin e Verifikimin e Pronës
MARRI - Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë
MM - Marrëveshje mirëkuptimi
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KM - Kryeministri
RCC - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
ReSPA - Shkolla Rajonale e Administratës Publike
SEECF - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
SELEC - Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore